

Projektet me GIZ

GIZ gjerman ka qene gjithmonë në mbështetje të iniciativave nga stafi i UKZ-së. Falë bashkëpunimit të mirë kemi arritur të organizojmë tre konferenca lidhur me pilot projektin “Klasa 1 deri 5- Një apo më shumë mësues”. Idenë për këtë projekt e ka dhënë stafi UKZ-së, i cili ka organizuar tri tryeza debatuese, ku ka ftuar personat përgjegjës si mësues, prindër, psikolog, përfaqësues të institucioneve. Janë diskutuar shumë aspekte se a do të mund të implementohet dhe a është i mirë për fëmijët dhe mësime dhënësit e shkollave fillore. Ky projekt ka filluar të implementohet fillimisht si pilot në një shkollë fillore në Gjilan, dhe pas dy viteve, është zgjeruar edhe në disa shkolla tjera në Gjilan dhe në disa qytete të tjera në Kosovë. Pas një viti të implementimit, është mbajtur konferenca, ku janë prezantuar të gjeturat nga hulumtimi në shkollën ku ka filluar të implementohet.

Në kuadër të bashkëpunimit me GIZ, gjithashtu është mundësuar që të zhvillohen edhe disa trajnime me studentë dhe profesorë të Fakultetit të Edukimit. Janë mbajtur dy trajnime për studentë të Fakultetit të Edukimit “Vlerësimi Sumativ dhe Hartimi i Testit 1-9”. Poashtu studentët dhe profesorët e UKZ-së janë trajnuar për programin e hulumtimit dhe nxjerrjen e të dhënave “SPSS”.

Dhe në përfundim të projektit GIZ ka financuar edhe të gjitha programet e veta të trajnimit për Institutin e UKZ-së, duke i dhënë të gjitha programet e trajnimit Institutit të Fakultetit të Edukimit, me qëllim që Instituti të fillojë trajnimet e mësuesve në module të ndryshme, duke filluar edhe certifikimin e tyre dhe poentimin gjithashtu.